UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZYRA E PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr 1320/5 Prot
Datë 31.10.2017

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. ............. Prot.

Tiranë, më 20.10.2017

**Vendim**
**Nr. 34 , datë 20.10.2017**

**PËR PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE MBI 30% PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017**

Bazuar në nenin 3, pika 3d, 49/a të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", pika 4 dhe pika 20 e udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "*Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë*", si dhe referurar shkresës me nr. 1283/1 Prot, datë 17.10.2017 e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, shkresës me nr. 1283, datë 16.10.2017 të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe relacioneve përkatëse, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.10.2017

**VENDOSI:**

1. Të miratojë pagesën e orëve mësimore të realizuar për vitin akademik 2016-2017 mbi normën e miratuar për personelin akademik me kohë të plotë në masën 70%.
2. Në këtë pagesë nuk përfshihet pagesa e mbingarkesës deri në 30% e likujduar nga Titullari i Institucionit.
3. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Administratori dhe Drejtoria e Financës dhe Realizimit të Buxhetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Bashkangjitur këtij vendimi vendoset një kopje e shkresës nr. 1264/1, datë 11.10.2017, relacioni i Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe dokumentacioni shoqërues.

1. Rezana Vrapi – Kryetar
2. Florian Nurçe – anëtar

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site:www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



OLSI VANGJELI

3. Enida Pulaj – anëtar
4. Eduard Ahmeti – anëtar
5. Elsajed Rexhaj – anëtar
6. Marinela Muço – anëtar
7. Ornela Koleka - anëtar

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site:www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al